



Npi – 01/174 datë: 02.05.2025

Duke u bazuar në nenin 12.2 shkronja (d) dhe nenin 17 shkronja (o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” Nr.28/2008); Nenin 7, 8, 10 të Ligjit për Sistemin e Adresave në Republikën e Kosovës Nr.04/L-071; Statutin e Komunës së Shtimes 01Nr.06/1636 të datës 03.09.2008; Kuvendi i Komunës së Shtimes pasi analizoi listën e Kërkesave për emërtimin e rrugëve dhe shesheve Npi – 01/45 datë: 12.02.2025, dhe duke marrë parasysh edhe Rekomandimin e Komisionit Npi-01/60 të datës 13.03.2025, si dhe Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa Npi-01/118 të datës 01.04.2025, Kuvendi i Komunës në seancën e jashtëzakonshme të mbajtur më 02.05.2025 miratoi këtë:

V E N D I M

PËR REFUZIMIN E KËRKESËS TË SELAMI RASHITI

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në seancën e jashtëzakonshme, të mbajtur më: 02.05.2025, me shumicën e votave vendosi të REFUZOJË Kërkesën Nr: 06-350/02-30259/24 datë:19.11.2024, të Selami Rashiti nga fshati Petrovë, për emërtimin e rrugës së re në Shtime me emrin “Zejnush Rashiti”.

II

Kërkesa: z.Selami Rashiti, Petrovë, Kërkesa Nr: 06-350/02-30259/24 datë:19.11.2024, ka kërkuar emërtimin e një rruge të re me emrin e Veteranit “Zejnush Rashiti”. Rruga gjindet te restorant “Lisi” në Shtime e cila lidhet me rrugët “Skender Salihaj” dhe rrugën “Ahmet Shtimja”. Emri i propozuar i përket familjarëve të palës. Kërkesa është individuale dhe nuk ka ndonjë petition ose nënshkrime të banorëve të zonës. Arsytimi për emërtimin e rrugës është dhënë se ky emër i propozuar është i familjes tonë, dhe Veterani tani i ndjerë “Zejnush Rashiti” ka dhënë kontributin e tij për shtet nga themelimi i Lidhjes Demokratike të Kosovës e deri te çlirimi dhe pavarësia e Kosovës. Ka qenë pjestarë i UÇK-së dhe është themelues i pikës së Rancës së bashku me shokët.

III

- Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 06.12.2024, unanimisht miratoi Konkluzionin Npi – 01/401, që kërkesën Nr:06-350/02-0030259/24 datë:19.11.2024, të z.Selami Rashiti, nga fshati Petrovë, ta shqyrtoi më detaisht, duke shikuar vendin e ngjarjes që i përket kërkesës së parashtruar, vizita me një Gjeodet për ta definuar saktë trasën e rrugës se a është rrugë publike apo jo, si dhe nëse kjo rrugë i plotëson kriteret ligjore për emërtimin e sajë. Komisioni konstaton se ajo zonë është pronë Komunale.
- Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 18.12.2024, unanimisht vendosi që të miratoi Rekomandimin Npi – 01/60 për Kuvendin e Komunës që të refuzojë Kërkesën Nr:06-350/02-30259/24 datë: 19.11.2024, të Selami Rashiti - Petrovë me arsyetimin se rruga tani nuk është e hapur deri në fund dhe nuk i plotëson kriteret ligjore. Por në të ardhmen me plotësimin e kriterëve ligjore kjo rrugë mund të emërtohet.
- Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen më datën 01.04.2025 miratoi Rekomandimin, Npi – 01/118, me të cilin Kuvendit të Komunës i Rekomandon Refuzimin e kësaj kërkesë.
- Duke marrë parasysh të gjitha këto Kuvendi mori vendim sikurse në Dispozitiv.

IV

Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e rexhistrimit në evidencën e protokolit zyrtar në MAPL, si dhe 7 ditë pas publikimit në Ueb – faqen zyrtare të Komunës së Shtimes.

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palës, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi